



Prishtinë: 05.09.2022

Kodi i ZRRE-së: V_1585_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2343_08_22**.

në seancën e mbajtur më datë 05.09.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **K.Ç SH.P.K** nga Komuna e Pejës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi

A r s y e t i m

Konsumatori **K.Ç, SH.P.K**, në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 20.04.2022 ka apeluar përgjigjen e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 05.05.2022 lidhur me kontestimin e faturës per periudhën shkurt 2022 dhe korrigjimit nr. 62043DPE-9051933 datë 06.04.2022, për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë.

Me datë 09.02.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 50882857 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=14864.290 kWh dhe TU=4719.573 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=8244,331 kVAR dhe TU=599,769 kVAR, konstant llogaritëse C=15 si dhe gjendjen momentale të maksigrafit 6,6510. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka bërë shqyrtimin e njehsorit ku ka evidentuar se kontrollohet GM dhe ka bërë evidentimin e TMRR me herës transformimi 300/5A të cilat bllobohen si dhe kanë evidentuar se GM është vendosur në panelin e ri sipas PEE me Nr.7748 datë 10.08.2021 dhe pranimit teknik Nr.11324 datë 11.11.2021 si dhe që duhet bërë ndërrimi i konstantes llogaritëse nga C=15 në C=60.

Provë: Procesverbali mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 0003730 datë 09.02.2022

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 01.03.2022 i ka dërguar konsumatorit dy fatura mujore të energjisë elektrike për periudhën shkurt 2022 (faturat nr. 0222123703DPE-9051933 dhe nr. 02220DPE-9051933) një të vlerë financiare **388.99€** dhe tjetrën në vlerë financiare **2,097.62€**.

Provë: Faturat nr.0222123703DPE-9051933 dhe nr.02220DPE-9051933 datë 01.03.2022



Me datë 09.03.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin e periudhës shkurt 2022 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë.

Provë: Ankesa e konsumatorit datë 09.03.2022

Konsumatori në mungesë të përgjigjes nga KESCO në ankesën e tij, me datë 20.04.2022 përmes postes elektronike ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar faturimin e periudhës shkurt 2022 .

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 20.04.2022

Me datë 05.05.2022 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij si dhe ka bërë korrigjimin e faturave të periudhës shkurt 2022 në vlerë financiare **-960.02€** duke potencuar se korrigjimi i faturave bëhet për shkak të ndërrimit të konstantes llogaritëse me datë 09.02.2022. Përgjigjen e KESCO-s konsumatori e ka dorëzuar në ZRRE përmes parashtresës së datës 24.05.2022.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 05.05.2022

Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS/KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 09.02.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 50882857 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=14864.290 kWh dhe TU=4719.573 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=8244,331 kVAr dhe TU=599,769 kVAr, konstant llogaritëse C=15 si dhe gjendjen momentale të maksigrafit 6,6510. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka bërë shqyrtimin e njehsorit ku ka evidentuar se kontrollohet GM dhe ka bërë evidentimin e TMRR me herës transformimi 300/5A të cilat bllobohen si dhe kanë evidentuar se GM është vendosur në panelin e ri sipas PEE me Nr.7748 datë 10.08.2021 dhe pranimit teknik Nr.11324 datë 11.11.2021 si dhe që duhet bërë ndërrimi i konstantes llogaritëse nga C=15 në C=60.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 01.03.2022 i ka dërguar konsumatorit dy fatura mujore të energjisë elektrike për periudhën shkurt 2022, faturën 0222123703DPE-9051933 e cila ka përfshi periudhën 01.02.2022 deri në periudhën 09.02.2022 për **6,065.7 kWh** apo shprehur vlerë financiare **388.99€** dhe faturën 02220DPE-9051933 për **12,587.4 kWh** apo shprehur në vlerë financiare **2,097.62€** e cila ka përfshi periudhën nga data 09.02.2022 deri me datë 01.03.2022 si dhe fuqinë maksimale. Me datë 09.03.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin e periudhës shkurt 2022 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë dhe se me datë 05.05.2022 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij si dhe ka bërë korrigjimin e faturave të periudhës shkurt 2022 në vlerë financiare **-960.02€** duke potencuar se korrigjimi i faturave bëhet për shkak të ndërrimit të konstantes llogaritëse me datë 09.02.2022.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga KEDS/KESCO vërtetohet se komisioni për korrigjimin e faturave në KEDS me datë 15.03.2022 pas ankesës së konsumatorit të datës 09.03.2022 ka lëshuar vendimin për korrigjimin e faturave të periudhës shkurt 2022 bazuar në analizën e shpenzimeve të konsumatorit si dhe ndërrimit të konstantes llogaritëse nga C=15



ne C=60. Ne vendimin e komisionit është evidentuar se: Gjatë analizës se konsumit te konsumatorit është vërtetuar se konsumatori ka rritje te konsumit muajve te fundit, ku rrymat ne tri fazat kane tejkaluar vlerën 5A, kësaj ekipet e autorizuar te KEDS-it me datë 09.02.2022 ora 10:30 kane bërë ndërrimin e TMRR-ve nga C=15 në C=60. Andaj faturat e periudhës 02/2022 janë ndare ne dy periudha , Perioda I- nga data 01.02.2022 deri me datë 09.02.2022 ku faturimi i energjisë aktive dhe reaktive behet me konstant C=15, ndërsa Perioda II-nga data 09.02.2022 deri me datë 28.02.2022, ku faturimi i energjisë aktive dhe reaktive behet me konstant C=60. Ne faturën e muajit 02/2022 vërehet se fuqia maksimale është faturuar me konstant llogaritëse C=60, ndërsa vlera e fuqisë maksimale është arritur me datë 04.02.2022 me C=15, pra para ndërrimit te TMRR. Përkatësisht vlera e fuqisë maksimale qe duhet te faturohet per periudhën 02/2022 është $P_{max}=6.651*15=99.765$ kW. Bazuar ne vendimin e komisionit per korrjgimin e faturave, Departamenti i faturimit ne KESCO me datë 06.04.2022 përmes korrjgimit nr. 62043DPE-9051933 ka bërë korrjgimin e faturave te periudhës shkurt 2022 në vlerë financiare **-960.02€**. Bordi i ZRRE ka shqyrtuar korrjgimin nr. 62043DPE-9051933 datë 06.04.2022 të bere nga Departamenti i faturimit ne KESCO per faturat e periudhës shkurt 2022 dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se:3. *Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrjgimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.*

KEDS ka ofruar po ashtu Pëlqimin elektroenergjetik Nr.7748 datë 10.08.2021 si dhe pranimin teknik Nr.11324 datë 11.11.2021 me te cilin vërtetohet se konsumatori Rexhep Çeku është pajisur me PEE bazuar ne kërkesën per rritje te fuqisë nga **47.40 kW** ne **198 kW** si dhe ka vendosur TS me fuqi 250 kVa. Ne piken 3 të PEE së lëshuar nga KEDS lidhur me kushtet e parapara per matjen e energjisë se shpenzuar vërtetohet se matja e energjisë se shpenzuar do te behet ne shifrën DPE 9051933 "Bizmarket" SH.P.K Krenar Çeku me metodën gjysme indirekte me njehsorë elektrik multi-funksional(aktiv, reaktiv dhe maksigraf) 3x230/400V, 5A, me grup tariforë 6/6 përmes transformatorëve matës rrymor me koeficient transformimi 300/5 A te shkalles se saktësisë 0.5 S klasë 10(15)VA F55. Po ashtu edhe ne raportin teknik mbi pranimin vërtetohet se matja e energjisë behet sipas kushteve teknike te vendosura ne piken 3 te PEE ku TMRR janë te herësit transformues 300/5A. Bazuar ne kushtet e përcaktuara ne piken 3 te PEE Nr.7748 si dhe Raportit teknik vërtetohet se KEDS/KESCO me rastin e ndërrimit te konstantes llogaritëse kanë vepruar konform 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme), 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*



Bordi i ZRRE duke pasur parasysh te gjitha faktet e përmendura me lartë, dëshmitë dhe argumenteve të paraqitura nga palët e ne veçanti analizës së konsumit, procesverbalin mbi montimin-demontimin-ndërrimin e grupit matës nr. 0003730 datë 09.02.2022, pëlqimin elektroenergjetik Nr.7748 datë 10.08.2021, raportin per pranimin teknik Nr.11324 datë 11.11.2021 si dhe korrigjimin nr. 62043DPE-9051933 datë 06.04.2022 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: **K.Ç SH.P.K**
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.